VENDIM
Nr.10, datë 18.2.2011

PËR MOSPRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "ALBANIAN CHROME" PËR MARRJEN E STATUSIT TË KLIENTIT TARIFOR

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 7 dhe 8 të "Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006, pikës 7, germa "a" të modelit shqiptar të tregut, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2009 dhe pikës IV.2 të rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike miratuar me vendimin nr.68, datë 23.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.2.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Albanian Chrome", për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe rikthimin në statusin e klientit tarifor,

konstatoi se:

- Së pari, aplikimi për kthimin e "Albanian Chrome" në statusin e klientit tarifor nga data 1 shkurt 2011, nuk i plotëson kërkesat e rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar, si dhe rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike, pasi kërkesa nuk është paraqitur në respektim të afateve të përcaktuara nga këto rregullore.
- Së dyti, kalimi i "Albanian Chrome" nga klient i kualifikuar në klient tarifor sipas vendimit nr.100, datë 7.12.2010, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nuk është i mundshëm, pasi kthimi i tij në klient tarifor do të sillte kosto të reja shtesë për KESH sh.a., si dhe do të cenonte sigurinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët tariforë, nëse këto kosto nuk do t'i mbulohen nga KESH sh.a. nëpërmjet tarifës së furnizimit me shumicë të energjisë elektrike për këtë konsumator.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë kërkesën e shoqërisë "Albanian Chrome" për marrjen e statusit të klientit tarifor sipas kërkesës së tij për kthimin në klient tarifor nga data 1 shkurt 2011, dhe sipas çmimeve të miratuara nga ERE me vendimin nr.100, datë 7.12.2010.
2. "Albanian Chrome" mund të aplikojë për marrjen e statusit të klientit tarifor në përputhje me kriteret, siç përcaktohen në rregulloren për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar dhe rregullat e tregut, me një çmim shtesë siç mund të përcaktohet nga ERE.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë "Albanian Chrome" për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta